




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 204/3 prot.

Pukë, më 12.02. 2026

VENDIM

Nr. 08 datë 11.02. 2026

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË
Z. PASHK KOL LLESHI (pas vdekjes)”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me date 11.02.2026, pas shqyrtimit;

VENDOSI:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. PASHK KOL LLESHI (pas vdekjes)

Me motivacionin:

“Në nderim dhe vlerësim të një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe frymë misionari dha një kontribut të çmuar në përhapjen e dijes dhe ngritjen e arsimit në shumë fshatra të Njesisë Administrative Gjegan dhe më gjerë, duke u shndërruar në frymëzim të brezave dhe në shembull të përhershëm të mësuesit të vërtet”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

4. Vendimi u shpall me date **12. 02 .2026**

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA

